



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 682, Datë 05.03.2020

**“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Dasof doo. nga shoqëria Porsche Informatik Gesellschaft mbH.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.03.2020, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Dasof doo nga shoqëria Porsche Informatik Gesellschaft mbH.

**Baza Ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, dhe formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Dasof doo nga shoqëria Porsche Informatik Gesellschaft mbH.

**VËREN SE :**

**Transaksioni dhe përqendrimi**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfutimin e kontrollit të shoqërisë Dasof doo nga shoqëria Porsche Informatik Gesellschaft mbH.

*Pala blerëse:* Porsche Informatik Gesellschaft mbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me legjislacionin austriak, me objekt veprimtarie: prodhimi i makinerive, pjesëve të makinerive dhe prodhimi i mallrave metalike dhe plastike dhe shitja e këtyre mallrave; riparimi i motorëve dhe mjeteve motorike; tregtimi i mallrave të të gjitha llojeve; prodhimi, riparimi dhe

tregtimi i pajisjeve aeronautike; prodhimi industrial i pjesëve elektronike; ofrimi i shërbimeve në përpunimin automatik të të dhënave dhe teknologjinë e informacionit; pjesëmarrja edhe si ortak me përgjegjësi personale në sipërmarrje me objekt të njëjtë ose të ngjashëm.

Porsche Informatik Gesellschaft mbH është filial i drejtpërdrejtë i Porsche Holding Gesellschaft mbH me seli në Salzburg, shoqëri e cila ushtron veprimtarinë e saj në tregtimin e makinave në Evropë. Porsche Holding Gesellschaft mbH është filial i drejtpërdrejtë i Volkswagen AG, e cila është shoqëria mëmë e Grupit VW.

Në Shqipëri, Porsche Informatik Gesellschaft mbH (tërthorazi përmes filialeve të Grupit VW në Shqipëri) është aktive në konsulencën e produktit dhe procesit, zhvillimin e programeve informatike, shërbimet e prezantimit, trajnimit, operimin e shërbimeve të ofertuesit të shërbimit të aplikacionit (OSHA).

*Pala shitëse:*

- Z. D K, është person fizik dhe shtetas slloven.

- Z. A P është person fizik, dhe shtetas slloven.

*Shoqëri Target:* Dasof doo, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit të Sllovenisë, me objekt veprimtarie: shitje me pakicë të pajisjeve kompjuterike në dyqane të specializuara për programet të telekomunikacionit e pajisjeve audio dhe video, programim kompjuterik, etj.

### **Vlerësimi i përqendrimit**

Më datë 12 Dhjetor 2019, midis blerësit Porsche Informatik Gesellschaft mbH dhe palës shitëse Z. DK dhe Z. AP është nënshkruar “Kontratë për blerje dhe shitje aksionesh”, të shoqërisë target Dasof doo.

Bazuar në dispozitat dhe kushtet e kësaj kontrate, blerësi synon të blejë gjithsej 85 % (tetëdhjetë e pesë) të aksioneve në shoqëri nga shitësit dhe shitësit dëshirojnë të shesin aksionet tek blerësi. Pjesa e mbetur prej 15 (pesëmbëdhjetë) % e aksioneve të shoqërisë përfaqëson aksionet e veta të shoqërisë, të cilat gjithashtu janë të regjistruara në shoqëri dhe nuk kanë asnjë kufizim.

Kontrolli i qëndrueshëm mbi shoqërinë Dasof doo, është përfundim kontrolli nga pala blerëse Porsche Informatik Gesellschaft mbH dhe ky transaksion plotëson kriteret e nenit 10, pika 1 germa b të Ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Referuar pasqyrave financiare të palëve në marrëveshje, transaksioni plotëson edhe kriteret e përcaktuara në 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Sipas nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës” si dhe duke marrë në konsideratë natyrën e transaksionit dhe praktikën më të mira të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit është lënë i hapur dhe përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përftimi i kontrollit të Dasof doo. nga Porsche Informatik Gesellschaft mbH. Shoqëria Target Dasof doo. nuk operon në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të shoqërisë Dasof doo nga shoqëria Porsche Informatik Gesellschaft mbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**